

## Thirrje publike për vitin 2020

06.07.2020

Laboratori për Aktivitete të Biznesit (LAB), bënë ftesë publike për të aplikuar për përkrahje investive për themelimin e bizneseve të reja familjare apo zgjerimin e atyre ekzistuese në sektorin e agropylltarisë.

Nën skemën e Programit LAB - plani vjetor për vitin 2020, kjo përkrahje është siguruar nga donacionet e dhuruara nga themeluesi i këtij fondacioni Titan Group – Sharrcem sh.p.k, Hani i Elezit.

Objekti i thirrjes është përkrahja e kërkesave individuale të fermerëve nga Komuna e Hanit të Elezit, për të investuar në themelimin e bizneseve familjare në sektorin agropjor dhe përmirësuar njohurit për aplikimin e metodave inovative të menaxhimit të fermës që rritë prodhimtarinë bujqësore, të hyrat dhe krijon vende të reja pune – vetëpunësim.

### Si të aplikohet?

Fermerët e interesuar mund të shkarkojnë formën dhe udhëzuesin për plotësimin e aplikacionit nga web faqja e LAB-it [www.lab-ks.org](http://www.lab-ks.org), ose ti marrin ato personalisht në zyrat e LAB-it e cila gjendet në Rr. “Adem Jashari” nr.218 - Hani i Elezit.

Aplikacionet mund të dërgohen përmes e-mailit në adresën [hysen.shabanaj@lab-ks.org](mailto:hysen.shabanaj@lab-ks.org) /ose të dorëzohen direkt në zyrat tona, duke filluar nga data e publikimit të thirrjes deri me 31/07/2020

Vetëm aplikacionet e kompletuara, të dërguara përmes e-mailit në adresën [hysen.shabanaj@lab-ks.org](mailto:hysen.shabanaj@lab-ks.org), ose të dorëzuara direkt në zyrat tona brenda afatit për aplikim, do të konsiderohen për vlerësim.

### Afatet

Aplikacionet e kompletuara më dëshmitë e bashkangjitura mund të dërgohen përmes e-mailit në adresën [hysen.shabanaj@lab-ks.org](mailto:hysen.shabanaj@lab-ks.org), ose të dorëzohen direkt në zyrat tona duke filluar nga data e publikimit të thirrjes 06.07.2020 deri me datë 31/07/2020

Konfirmimi i pranimit të aplikacionit bëhet më së largu tri ditë pas pranimit të aplikimit përmes e-mailit ose menjëherë pas dorëzimit të kërkesës në zyrat tona. Nëse një konfirmim i tillë nuk është marrë në këto afate kohore, ju lutem na kontaktoni duke na shkruar në adresën tonë të e-mailit ose përmes telefonit +383 290 385 500 lokalit 1120.

Kandidatët do të informohen për rezultatet e vlerësimit me e-mail, përmes publikimit të listës së përfituesve në web faqen e LAB – it dhe në tabelën e shpalljeve publike në objektin e Komunës së Hanit të Elezit.

Nëse keni ndonjë pyetje shtesë në lidhje me thirrjen, ju lutem na kontaktoni përmes e-mailit në adresën [hysen.shabanaj@lab-ks.org](mailto:hysen.shabanaj@lab-ks.org).

Na ndihmoni duke ndarë këtë informatë me të gjithë të njohurit tuaj!

### Sektorët të cilët do të përkrahen:

#### **1. Serra**

Objekti: Rritja e kapaciteteve prodhuese për kultivim të perim kulturave në Serra, për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese ose themelimin e aktiviteteve të reja prodhuese në sektoret që do të mbështeten në vitin 2020.

Titulli: Furnizim me Serra të tipit “Bllok” me sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup>, farëra, fidane dhe inpute tjera përcjellëse, deri në dy përfitues/e.

#### **2. Bletari**

Objekti: Furnizimi me paisje dhe inpute tjera përcjellëse të domosdoshme, të cilat ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mirëmbajtjes, prodhimtarisë dhe ruajtjes së mjaltit që përmbushin standardet e ushqimit.

Titulli: Furnizimi me paisje të domosdoshme për mirëmbajtjen e bletishteve ekzistuese deri në 10 përfitues/e.

#### **3. Ngritja e plantacioneve të Gështenjës**

Objekti: Themelimi i plantacioneve eksperimentale për kultivimin intenziv të gështenjës me kultivar të cilat kanë fruta cilësor, produktivitet të lartë dhe posedojnë nivel të rritur të rezistencës ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve.

Titulli: Furnizimi me fidane, sistem të ujitjes dhe rrethojë për ngritjen e 2.00 ha sipërfaqe të plantacioneve me gështenjë.